



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 11

Datë: 06. 03. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Pjesëmarrës në takim:

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 8, 9, 10/2024
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregulloreve Zgjedhore Nr. 01, 02, 03, 04/2024
4. Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Sami Kurteshi: Unë këtë pikë të miratimit të procesverbaleve propozoj ta lëmë në të ndryshme. Ka cka me u diskutue.

Kreshnik Radoniqi: E hapi mbledhjen e 11-të. Pika e parë: shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve: 1,2,3 dhe 4. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve, mbetet “në të ndryshme” si pikë e mbyllur...

Me 1 vota për, miratohet rendi i ditës.

Kreshnik Radoniqi: Po fillojmë me rregullore menjëherë! Mbasi që ka hy në fuqi ligji i ri për zgjedhjet e përgjithshme, kemi filluar me punuar në rregullore. I kemi trajtuar në disa punëtori të ndryshme. Kemi punuar në KQZ rregullisht.

E kemi rregulloren nr. 1/24 Për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Partive Politike. A, ka me dikush diçka lidhur me këtë rregullore...?

Sami Kurteshi: Kjo është punuar njëherë, duhet të ndërrohet data, dhe nuk kam vërejtje tjera. Teknikisht, nuk e di pse e kanë prekë...Jam për.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e rregullores nr. 1/24 Për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Partive Politike ?

Me 11 vota për (Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj) , miratohet.

Kreshnik Radoniqi: Në radhë është rregullorja nr. 2/24 Për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

A, ka me dikush diçka lidhur me këtë rregullore...?

Sami Kurteshi: Duhet ta kenë parasysh datën. Për mua është në rregull. Le ti shohin edhe gjuhësisht, ka diku gabime, le të përmirësohen.

Kreshnik Radoniqi: Tjetër...? Atëherë, kush është për ?

Me 11 vota për (Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj) , miratohet rregullorja nr. 2/24 Për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

Në radhë është rregullorja nr. 3/24 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës Votuese. A ka diçka të thuhet ?

Sami Kurteshi: E njëjta për datën. Te neni 6, nen paragrafi 6.2, jo 6.1.1 se nuk ka kuptim. Neni 7, paragrafi 7 “për raundin e dytë të zgjedhjeve” përmbajtja ka mbet me ngjyrë të verdhë. Fjalja është mirë, ngjyra duhet të hiqet.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka ? Nëse jo, e hedh në votim ? Kush është për ?

Me 11 vota për (Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj) , miratohet rregullorja nr. 3/24 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës Votuese. A ka diçka të thuhet ?

E kemi edhe rregulloren nr.4/24 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre.

A ka dikush tjetër diçka...?

Sami Kurteshi: Vlejnë të njëjtat, të hiqen ngjyrat dhe të dërgohen për nënshkrim.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka ? Nëse nuk ka, e hedh në votim ? Kush është për ?

Me 11 vota për (Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj) , miratohet rregullorja nr.4/24 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre.

Sami Kurteshi: Katër rregullore, janë dërgua dhe po besoj se janë përkthye...!

Kreshnik Radoniqi: Po besoj të premtën, e përmbylim me miratim të rregulloreve.

1.Të ndryshme !

Alban Krasniqi: Kush e ka lexue që ne ta dimë se mbi çfarë baze është anuluar...? Mbi bazën e rregulloreve tona ? Ato, tani e lejojnë.

Sami Kurteshi: Ne, i kemi pranuar 3 procesverbale. Që është vonësë prej dy muajve. Kjo, tregon papërgjegjësi, mos punë. Kërkoj nga krye shefi që, procesmbajtësi me qenë në mbledhje.

Duket si burokraci, por kjo degradohet. Nuk është që pse e përmendim shpesh. Procesverbali duhet, mund t'iu duhet edhe institucioneve të tjera. Nuk duhet me u burokratizua puna, çështjet. Ne, na duhet procesverbali, me u ditë çka ke pyet, çka ke votue!

Ne, e kemi stenogramin, por na duhet procesverbali. Unë, prej mbledhjes së ardhshme do të kërkoj në mbledhje se, kush është procesmbajtësi ? Unë, nuk votoj tash e tutje procesverbal nëse nuk vjen me kohë. Kjo është çështja, edhe nëse pyetja ime është pa lidhje, le të jetë pa lidhje, le të shkruhet kështu, por kërkoj që procesmbajtësi të jetë në mbledhje...

Një çështje tjetër, na dërgohen edhe dokumente, e kam tërheqë vërejtjen ! Ne, kërkojmë njerëzit me universitet. Së paku, shkronjat duhet me i ditë, duhet me i përdorë, po edhe me ditë përpunimin teknik në ëord. Është programi më i thjeshtë.

Këto janë që kisha nevojë ti them, se janë çështje procedurale.

Unë, e dërgova procesverbalin e fundit. Është relativisht i qartë, nuk ka pas vërejtje.

Gjithashtu, “me dyer të mbyllura”, pse nuk transkribohet...? Duhet të transkribohet.

Kreshnik Radoniqi: Pse nuk transkribohet pjesa “e mbyllur”, nuk e di si është praktika por duhet të transkribohet.

Arianit Elshani: Mua më erdh çudi që, ju e batë procesverbalin. Po vërehet që, bëhet më lehtë. Mjafton prezenca. Personi që e mban, nuk e ka pas përshkrim të vendit të punës. Për deri sa e ka, është mirë me qenë prezent.

Të jetë në çdo mbledhje.

Alban Krasniqi: Pasi që nuk është e rregulluar koha se kur duhet ta kemi procesverbalin, nxjerrim vendim që brenda 48 orëve, pas mbajtjes së mbledhjes ta kemi procesverbalin.

E dyta, të caktohet një person që do jetë në secilën mbledhje prezent.

Në ndërkohe, do të punojmë që t'i identifikojmë detyrat te përshkrimi i vendit të punës, por edhe te rregullorja e punës të sqarohen saktë çështjet..

Sami Krasniqi: Edhe te komiteti i auditimit nuk ka procesverbal, dy të fundit i kam mbajte unë. Në dy mbledhjet kam b'a vet procesverbal. Është punë e lehtë. Nuk shkon kështu...

Kreshnik Radoniqi: Janë 8, 9 edhe 10. Kush është për...?

Miratohen me 10 vota.

Shqyrtimi i ftesës për zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare në Republikën e Maqedonisë

Kreshnik Radoniqi: Nuk kishim mundësi me mbajttë takim të këshillit KMJ. Mirëpo, ka ardh një ftesë për vëzhgim të zgjedhjeve që mbahen në Maqedoninë e Veriut më 24 prill, dhe më 8 prill.

Zgjedhjet mbahen për President, dhe Parlamentare.

Këtu, ftesa është vetëm për 8 maj. Nuk ka tjera informacione. Deri më 13 prill, ka kohë për aplikimi.

E trajtojmë njëherë në KMJ, dhe mandej e sjellim.

E keni pa edhe një shkresë ë ka ardhë përmes AWEB –it për Ukrainën. Aty, ka disa pika për shkak të zgjedhjeve ruse në disa rajone: Donbas, Lugansk.

KQZ e Ukrainës ka kërkuar ë me ba një reagim. A dom ta bëjmë një reagim ?

Arianit Elshani: Po, si jo.

Kreshnik Radoniqi: Mbledhja përfundoi. Shihemi tw premtën.

